



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2021:101133
Datë: 21.06.2024
Numri i dokumentit: 05847917

KPPP.nr.1449/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Gent Bekeri, në çështjen përmbartimore të kreditorit NLB Banka (Banka e Re e Kosovës “brk” sh.a.p.k.), me seli në Prishtinë përfaqësuar nga Debt Loan recovery L.L.C. me seli në Prishtinë, kundër debitorit N.K.P. “Holding Company- AG” me NRB: 80261527, me seli në Prishtinë, të cilin e përfaqëson N.M. me vendbanim në Ferizaj Rr.”Fan Noli” nr.130. të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Halil Ilazi Avokat nga Ferizaj Rr.”Epopeja e Jezercit” nr.4, duke vendosur lidhur me kundërshtimin e debitorit të ushtruar kundër aktvendimit për ekzekutim E.nr.425/05 të datës 30.11.2005, të Gjykatës Komunale në Ferizaj, e cila lëndë pas dorëzimit tek përmbartuesi privat Bardh B. Tasholli mban numrin P.nr.444/19, jashtë seancës me datën 21.06.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

HEDHET POSHTË si i pa afatshëm kundërshtimi i debitorit N.K.P. “Holding Company- AG” me NRB: 80261527, i ushtruar kundër Aktvendimit për caktimin e përmbartimit E.nr.425/05 të datës 30.11.2005, të Gjykatës Komunale në Ferizaj.

A r s y e t i m

Gjykata Komunale në Ferizaj duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, ka caktuar përmbartimin me Aktvendimin E.nr.425/05 të datës 30.11.2005, duke lejuar përmbartimin në bazë të Aktvendimit të Gjykatës Komunale në Ferizaj N.d.nr.110/2001 të datës 25.07.2001, për lejimin e intabulimit të radhës së parë në pasurinë e patundshme të pronarit të debitorit N.M., ka caktuar përmbartimin në pasurinë e patundshme të debitorit për ta paguar borxhin kryesor prej 22,232.58 euro, në emër të provizionit shumë prej 2,045.17 euro dhe kamatën vjetore për vonesë në lartësi prej 3.5 % të shumës së borxhit kryesor të llogaritur nga data 13.03.2003, deri në pagesën definitive të borxhit si dhe shpenzimet e përmbartimit. Që të gjitha këto nga shitja e

patundshmërisë së tij e cila evidentohet në fletën poseduese nr.220 të datës 19.07.2001 K.K Ferizaj, si ngastër kad.nr.1110/8 me kulturë shtëpi, oborr, arë , në vendin e quajtur “Lloq i kuq”, në sipërfaqe të gjithëmbarshme prej 10.62 ari dhe nga çmimi i shitblerjes të kësaj patundshmërie të paguhet tërë borxhi ndaj kreditorit.

Debitori përmes të autorizuarit të tij ka parashtruara kundërshtim përmes të cilit e ka kundërshtuar aktvendimin për caktimin e ekzekutimit, ndër të tjerash ka deklaruar se nuk e konteston saktësinë e aktvendimit të Gjykatës Komunale në Ferizaj, mirëpo thekson se debitori ka marr mall në vlerë prej 24,630 DM, dhe i ka paguar eksportuesit shumën prej 10,000.00 DM, kështu borxhi i tërësishëm prej 24,630 DM ka mbetur pa paguar edhe 14,630 DM respektivisht 7,000.00 euro, e jo edhe shumën si në propozim. Ka theksuar se ekzekutmi është caktuar pa dokument ekzekutiv. I ka propozuar gjykatës që të pranohet kundërshtimi i debitorit, të prishet aktvendimi i E.nr.425/05 i datës 30.11.2005.

Kreditori nuk ka paraqitur përgjigje në prapësim.

Gjykata pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, gjeti se kundërshtimi i debitorit është i pa afatshëm për arsyet si në vijim:

Sipas vlerësimit të Gjykatës, debitori Aktvendimin për caktimin e ekzekutimit E.nr.425/05 të datës 30.11.2005, të Gjykatës Komunale në Ferizaj, e ka pranuar me datë 05.12.2005, e cila vërtetohet nga flete dërgesa për dorëzim personal të Gjykatës Komunale në Ferizaj që gjendet në shkresat e lëndës, ndërsa kundërshtimi nga ana e debitorit është ushtruar me datën 19.12.2005, siç vërtetohet nga vula e dorëzimit në postë.

Sipas dispozitës së nenit 70 të Ligjit për Procedurën Përmbartimore përcaktohet se *“Prapësimi duhet t'i paraqitet Gjykatës brenda shtatë (7) ditëve pas pranimit të vendimit përmbartues ose urdhrit përmbartues”*, ndërsa me nenin 126 par. 2 të LPK-së, përcaktohet se *“Në qofte se afati është caktuar me ditë, përjashtohet nga llogaritja dita në të cilën ka filluar ngjarja ose koha nga e cila duhet të filloj afati, kështu që për fillim të afatit merret dita e parë e ardhshme.”*

Andaj duke marrë parasysh faktin se në rastin konkret debitori Aktvendimin për caktimin e ekzekutimit E.nr.425/05 të datës 30.11.2005, e ka pranuar me datën 05.12.2005, ndërsa afati

për paraqitjen e kundërshtimit ka filluar të rrjedhë nga data 06.12.2005, rezulton se dita e fundit për paraqitjen e prapësimit ka qenë data 12.12.2005.

Meqenëse në rastin konkret debitori prapësimin e ka paraqitur me datën 19.12.2005, në Gjykatën Komunale në Ferizaj, ndërsa në shkresa të lëndës nuk ka prova se kundërshtimi është dorëzuar edhe në mënyra tjera të përcaktuara për dërgimin e shkresave, rezulton se debitori kundërshtimin e ka paraqitur me shtatë ditë vonesë.

Andaj bazuar në të lartcekurat, gjykata konform nenit 73 par.3 të LPP-së, dhe nenit 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.1449/22, datë 21.06.2024

Gjyqtari

Gent Bekeri

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimi të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.